


PROJEKT MARRËVESHJE NDARJE

Hekurudha Shqiptare sha

31 GUSHT 2023



Përbajtja

1)	Deklarime paraprake mbi operacionin e ndarjes	3
2)	Të dhëna mbi shoqëritë që marrin pjesë në ndarje.....	3
4)	Raporti i këmbimit të aksioneve të shoqërisë që ndahet.....	4
5)	Kushtet e ndarjes së aksioneve në shoqëritë pritëse.....	4
6)	Data kontabël e ndarjes.....	4
7)	Përparësi dhe privilegje të veçanta.....	4
8)	Pasojat e ndarjes për punëmarrësit (Plani social).	5

1) Deklarime paraprake mbi operacionin e ndarjes.

Kjo projektmarrëveshje është hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 216 të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

Në përputhje me parashikimet në Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit Nr. 1219 Prot, datë 21.01.2022 dhe Nr. 1219/2 Prot, datë 22.09.2022, shoqëria Hekurudha Shqiptare sha do të ndahet në katër shoqëri pritëse. Në përfundim të këtij operacioni të gjitha aktivet dhe pasivet e shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha transferohen te shoqëritë pritëse dhe kjo shoqëri vlerësohet e prishur dhe çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit pa kryerjen e likuidimit.

Operacioni i ndarjes do të realizohet në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe me Ligjin Nr. 90/2021 "Për ndarjen e shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha".

2) Të dhëna mbi shoqëritë që marrin pjesë në ndarje.

Shoqëria që ndahet është shoqëria Hekurudha Shqiptare sha, e regjistruar me numër unik J61811547D, është një shoqëri aksionare me dy nivele, me një kapital me vlerë 47.450.830.000 lekë, i përbërë nga 47,450,830 copë aksione të zakonshme, të zotëruar 100 përqind nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Shoqëria e ka selinë në adresën Lagjja nr.3, Rruga Egnatia, Durrës.

Shoqëritë pritëse do të janë shoqëri të reja, të themeluara rishtas për qëllimin e këtij operacioni ndarje. Forma, emri i regjistrimit dhe adresa e shoqërive pritëse që do të rezultojnë nga ndarja parashikohen si vijon.

Emri i regjistrimit	Forma ligjore	Adresa e selisë
Administruesi i Infrastrukturës sha	Shoqëri aksionare	Lagjja nr.3, Rruga Egnatia Godina e Drejtorisë se Përgjithshme te Hekurudhave, Kat 2, Durrës
Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve sha	Shoqëri aksionare	Lagjja nr. 4, Rruga Deshmoret Godina e Stacionit Hekurudhor te Udhëtarave, Kat 2, Durrës
Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit sha	Shoqëri aksionare	Lagjja nr. 13, Rruga Pavaresia Sektori Apollonia, Plazh, Durrës
Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhere sha	Shoqëri aksionare	Lagjja nr. 13, Rruga Pavaresia Sektori Apollonia, Plazh, Durrës

4) Raporti i këmbimit të aksioneve të shoqërisë që ndahet.

Aksionarët e shoqërisë që ndahet pranojnë kalimin e të gjitha aktiveve dhe pasiveve tek shoqëritë pritëse në përputhje me marrëveshjen dhe reportin e ndarjes dhe në këmbim do të bëhen aksionarë dhe do të zoterojnë aksione tek këto shoqëri pritëse sipas një raporti të këmbimit që është i drejtë dhe i arsyeshëm.

Aksionet e shoqërisë Hekurudha shqiptare sha zoterohen në nivelin 100 përqind nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, rrjedhimisht, aksionari Ministria e Financave dhe Ekonomisë pranon ndarjen e shoqërisë në këmbim të zotërimit në nivelin 100 përqind të aksioneve të të katër shoqërive pritëse.

Nga ky këmbim i aksioneve të shoqërisë që ndahet me aksionet e shoqërive pritëse, nuk do të rezultojë asnjë shumë e pagueshme në para.

5) Kushtet e ndarjes së aksioneve në shoqëritë pritëse.

Aksionet e shoqërive pritëse do të zoterohen në nivelin 100 përqind nga aksionari i vetëm Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Me zotërimin e 100 përqind të aksioneve të shoqërive pritëse, aksionari Ministria e Financave dhe Ekonomisë zotëron të gjitha të drejtat e pronësisë, pa kufizime, në të katër shoqëritë pritëse.

6) Data kontabël e ndarjes.

Meqenëse ndarja është mbështetur në pasqyrën e gjendjes financiare të shoqërisë të datës 30.06.2023, nga data 1.7.2023, të gjitha veprimet dhe ngjarjet ekonomike do të trajtohen nga pikpamja kontabël si të kryera nga shoqëritë pritëse dhe do të regjistrohen dhe paraqiten në librat kontabël të shoqërisë Administruesi i Infrastrukturës sha.

7) Përparësi dhe privilegje të veçanta.

Administratori dhe anëtarët e Këshilli Mbikqyrës të shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha, e cila ndahet, nuk përfitojnë privilegje apo ndonjë pérparësi të veçantë si pasojë e ndarjes.

Gjithashtu, audituesit ligjorë që janë caktuar për përgatitjen e reportit të ndarjes si dhe ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërisë që ndahet nuk do të kenë asnjë pérparësi të veçantë apo privilegji të caktuar në procesin e ndarjes dhe këta do të janë të pavarur në ushtrimin e detyrate dhe funksioneve të tyre.

8) Pasojat e ndarjes për punëmarrësit (Plani social).

Ndarja e shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha në vetvete përbën një riorganizim ligjor, ndërsa nga pikpamja e administrimit, aktualisht shoqëria është e organizuar në 5 sektorë, të cilët përbëjnë një bazë të mirë mbi të cilën mund të mbështetet ndarja. Një ekuivalentim i sektorëve aktuale me shoqëritë pritëse mund të paraqitet si vijon.

Sektori aktual ne Hekurudha Shqiptare sha	Shoqëria pritëse
Drejtoria	
NJBMIH (Njësia e biznesit të mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore)	Administruesi i Infrastrukturës sha
NJBU (Njësia e biznesit të udhëtarit)	Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve sha
NJBM (Njësia e biznesit të mallit)	Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit sha
NJSHTML (Njësia e shërbimit të mjeteve lëvizëse)	Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore sha

Sektorët Drejtoria dhe NJBMIH do të përfshihen në shoqërinë pritëse Administruesi i Infrastrukturës sha duke sjellë bashkimin e organikës dhe punëmarrësve, ndërsa sektorët e tjerë do të transformohen në shoqërinë përkatëse, rrjedhimisht nga pikpamja e administrimit nuk pritet të rezultojnë ndryshime të funksioneve apo veprimtarive operacionale të cilat kryhen aktualisht nga shoqëria Hekurudha Shqiptare sha.

Nga ndarja e shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha nuk pritet të rezultojë ndonjë pasojë mbi punëmarrësit e shoqërisë apo përfaqësuesit e tyre.



Gentian LIKO
Administrator
Hekurudha Shqiptare sha

31.08.2023